

## PROCESVERBAL

nga seanca e 7-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime  
Mediatike Audio dhe Audiovizuale  
mbajtur më 18.02.2025

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë:** Lazo Petrushevski, kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini, zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr.Alma Mashoviq, Llazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë:** dr. Metodija Jançeski.

**Në seancë ishte i pranishëm edhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.**

**Të pranishëm nga Shërbimi Profesional:** mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, mr.Emilija Petreska Kamenjarova, mr.Magdalena Davidovska Dovleva, Argjend Xhelili, Maja Damevska, dr.Ivana Stojanovska.

### **Të pranishmit e tjerë:/**

Kryetari i Këshillit, Lazo Petrushevski, hapi seancën e 7-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

## RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 6-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, mbajtur më 11.02.2025.
2. Propozime për fillimin e procedurave për heqjen e lejes për transmetim TV dhe RA të transmetuesve.
3. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup – televizioni i Maqedonisë – Shërbimi i tretë programor (RTM3) për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV.
4. Propozim për inicimin e procedurës për kundërvajtje të SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve.

5. Propozim-vendim për ndryshimin e strukturës së pronësisë të SHTR Plus forte SHPKNJP nga Tetova.
6. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – shërbim: Dhënia me qira e hapësirës për publikimin e shpalljeve në gazetën ditore.
7. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – mallra: pajisje TIK.
8. Të ndryshme.

### **Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe me 4 vota “pro” dhe një abstenim nga z.Trajçev, miratoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 6-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, të mbajtur më 11.02.2025, me tekstin e propozuar.

### **Pika 2**

Z. Petrushevski shpjegoi se materiali fillestar i seancës përfshin propozime për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim TV dhe radio të 10 transmetuesve. Mirëpo, ndërkohë TV EDO nga Saraj dhe EKO Radio nga Probishtip kanë paguar kompensimin vjetor, prandaj propozimet tani vlejné për 8 transmetuesit e mbetur. Ai propozoi t'u jepej një prezantim i përgjithshëm për të gjithë, dhe më pas çdo propozim të votohet veçmas.

Z. Trajçevski theksoi se këta 8 transmetues nuk e kanë paguar kompensimin vjetor në afatin e parashikuar, duke shkelur nenin 80, paragrafin (5) të LSHMAAV. Prandaj, propozohet iniciimi i procedurave për heqjen e lejeve të tyre. Gjithashtu, ai informoi Këshillin se pagesa e faturave të dhëna në muajin janar, të cilat përbëjnë rreth 90% të të gjitha faturave, është 87%. Kjo tregon se shumica e transmetuesve e kanë përmbushur detyrimin e tyre ligjor.

**2.1** Këshilli i Agjencisë njëzëri ka iniciuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të **SHTR ALFA TV SHPKNJP Shkup**, PA1 nr.08-1 datë 07.09.2023, për shkak të mospërmbushjes së detyrimit nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, përkatësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive sipas faturës së dorëzuar nr. 2025-100-0001 datë 10.01.2025.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR ALFA TV SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-1 datë 07.09.2023, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

**2.2** Këshilli i Agjencisë njëzëri ka iniciuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të **Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV MTM SHPKNJP Shkup**, PA1 nr.08-16, datë 07.09.2023, për shkak të mospërmbushjes së detyrimit nga neni 80, paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, përkatësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive sipas faturës së dorëzuar nr. 2025-100-0010 datë 10.01.2025.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, do të miratojë Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV MTM SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-16 datë 07.09.2023, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

**2.3** Këshilli i Agjencisë njëzëri ka iniciuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV Shutel SHPKNJP Shkup, Pa1 nr.08-18 datë 07.09.2023, për mospërbushje të detyrimit nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, përkatësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive sipas faturës së dorëzuar nr.2025-100-0011, datë 10.01.2025.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV Shutel SHPKNJP Shkup, PA1, PA1 nr.08-18 datë 07.09.2023, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

**2.4** Këshilli i Agjencisë njëzëri ka iniciuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të **Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI KOÇAN-LD SHPKNJP Koçan**, PA1 nr. 08-44, datë 07.09.2023, për shkak të mospërbushjes së detyrimit nga neni 80, paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale përkatësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas faturës së dhënë nr.2025-100-0011 datë 10.01.2025.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk paguan kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv, Këshilli i Agjencisë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për inicimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISION KOÇAN-LD SHPKNJP Koçan, PA1 nr.08-44 datë 07.09.2023, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

**2.5** Këshilli i Agjencisë njëzëri ka iniciuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të **Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive T.V. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJP**, PA1 nr.08-55, datë 07.09.2023, për shkak të mospërbushjes së detyrimit nga neni 80, paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, përkatësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, sipas faturës së dorëzuar nr.2025-100-0017 datë 10.01.2025.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk paguan kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për inicimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive T. V. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJP, PA1 nr.08-55 datë 07.09.2023, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

**2.6** Këshilli i Agjencisë njëzëri ka iniciuar procedurën për heqjen e lejes për transmetim në radio të **Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive GALAKSI – 2002 SHPKNJP Kavadar**, PA1 nr.08-100, datë 07.09.2023, për shkak të mospërbushjes së detyrimit nga neni 80, paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, përkatësisht nuk ka paguar

kompensimin vjetor për transmetim në radio Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele sipas faturës së dorëzuar nr.2025-100-0048 datë 10.01.2025.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk paguan kompensimin vjetor të lejes për transmetim në radio, Këshilli i Agjencisë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, do të miratojë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive GALAKSI- 2002 SHPKNJP Kavadar, PA1 nr.08-100 datë 07.09.2023, për shkak të shkeljes së nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

**2.7** Këshilli i Agjencisë njëzëri ka iniciuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të **Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RFM SHPKNJP Shkup**, PA1 nr.08-75, datë 07.09.2023, për shkak të mospërmbushjes së detyrimit nga neni 80, paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, përkatësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim në radio Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, sipas faturës së dorëzuar nr.2025-100-0034 datë 10.01.2025.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor të lejes për transmetim në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, do të miratojë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RFM SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-75 datë 07.09.2023, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

**2.8** Këshilli i Agjencisë njëzëri ka iniciuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të **Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive XHEZ FM SHPKNJP Shkup**, PA1 nr. 08-83, datë 07.09.2023, për shkak të mospërmbushjes së detyrimit nga neni 80, paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, përkatësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim në radio Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele sipas faturës së dorëzuar nr.2025-100-0039 datë 10.01.2025.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor të lejes për transmetim në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, do të miratojë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive XHEZ FM SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-83 datë 07.09.2023, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

### **Pika 3**

Ndihmës udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, z. Emilija Petreska – Kamenjarova, ka shpjeguar propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të NPR Radiotelevizioni i Maqedonisë- Shkup Televizioni i Maqedonisë – Shërbimi i tretë programor (RTM3), për shkak të shkeljes së nenit 51, paragrafi (1) të LSHMAAV. Ajo ka shpjeguar se gjatë mbikëqyrjes së rregullt administrative është konstatuar se RTM3 nuk ka publikuar të gjitha informatat që transmetuesi është i detyruar t'i vërë në dispozicion gjatë ditës, duke shkelur nenin e paraqitur të Ligjit. Duke qenë se kjo është shkelja e parë e këtij lloji në vitin aktual, propozohet që të shqiptohet masë vërejtje publike, me afat prej 20 ditësh për harmonizim, pas së cilës do të bëhet mbikëqyrje kontrolli.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer të rregullt administrative, nr.10-388/1 datë 27.01.2025 dhe njëzëri konstatoi që NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i Tretë

Programor (RTM3) t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV, sepse më 8 janar 2025, nuk arriti të sigurojë informacionin që duhet të vihej në dispozicion të përdoruesve.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas Aktvendimeve të Agjencisë për ndë marrjen e masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, është urdhëruar që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtjes publike ndaj transmetuesit të lartpërmendur.

Spektori për çështje juridike, pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Spektori për mbështetjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb- faqen e Agjencisë.

#### **Pika 4**

Ndihmës udhëheqësja e Spektorit për çështje programore, mr. Emilija Petreska-Kamenjarova, shpjegoi propozimin për iniciimin e procedurës kundërvajtëse kundër SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, për shkak të shkeljes së nenit 50, paragrafit (3) të LSHMAAV, si dhe neneve 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve. Ajo ka shpjeguar se raporti ka rezultuar nga mbikëqyrje e kontrollit programor, gjatë së cilës është konstatuar se transmetuesi sërish ka bërë të njëjtën shkelje për të cilën më herët ishte shqiptuar masë vërejtje publike. Është konstatuar se nuk zbaton plotësisht sinjalistikën për mbrojtjen e të miturve. Pavarsisht vërejtjes publike tashmë të shqiptuar dhe afatin e dhënë për harmonizim, transmetuesi nuk ka zbatuar masat e nevojshme dhe ka vazhduar me aplikimin e gabuar të sinjalizimit për programin e kategorisë së dytë (8+). Bazuar në këtë, propozohet miratimi i Aktvendimit për iniciimin e procedurës për kundërvajtje.

Z. Ajdini shprehu dilemë lidhur me kohën kur transmetuesi ka marrë masën e paralajmërimit publik dhe pyeti nëse atëherë transmetuesi ka bërë deklaratë?

Ndihmës udhëheqësja, mr. Emilija Petreska- Kamenjarova, u përgjigj se masa vërejtje publike është shqiptuar më 18.11.2024, me afat për harmonizim prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit. Ajo vuri në dukje se transmetuesi, si të gjithë të tjerëve të cilëve u është shqiptuar vërejtje publike, ka marrë kërkesë për deklaratë. Po ashtu, ai ka sqaruar se mbikëqyrja është zbatuar mbi katër transmetues. Tre transmetuesit e mbetur treguan nivele të ndryshme të pajtueshmërisë - disa e eliminuan plotësisht shkeljen, ndërsa të tjerët bënë përpjekje për ta korigjuar, por jo plotësisht, prandaj atyre iu dërgua shkresë për harmonizim plotësues. Megjithatë, tek TV Kompani 21-M nuk është vërejtur asnjë lëvizje drejt harmonizimit me rregullativën.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer të kontrollit programor nr.10-5362/1 datë 30.12.2024 të SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup dhe konstatoi shkelje të nenit 50 paragrafit (3) të LSHMAAV dhe neneve 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve.

Këshilli njëzëri konkludoi kundër SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup të iniciohet procedurë për kundërvajtje para gjykatës kompetente, sepse nga mbikëqyrja e kontrollit programor është konstatuar se në shërbimin programor të transmetuesit të lartpërmendur, më 11 dhjetor 2024, në nivel shtetëror, transmetuesi nuk ka vepruar sipas Aktvendimit për shqiptimin e masës – vërejtje publike, përkatësisht me aplikim të gabuar të sinjalistikës për program të kategorisë së dytë (8+), u transmetuan episodet premiera dhe repriza të serialit artistik "I egri ( Yabani )" dhe episodi premierë i serialit artistik " Jetë të thyera"( Kirik hayatlar)", që është në kundërshtim me nenin 50 paragrafin (3) të LSHMAAV dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve .

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë Kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente për SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup.

## **Pika 5**

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, ka shpjeguar Propozim-vendimin për ndryshim të strukturës së pronësisë të SHTR Plus Forte SHPKNJP nga Tetova. Ajo shpjegoi se në dhjetor të vitit të kaluar Agjencia është vënë në dijeni për mundësinë e shkeljes së nenit 38 të Ligjit, i cili ndalon bartësit e funksioneve publike dhe anëtarët e familjeve të tyre të jenë themelues të transmetuesve. Konkretisht, ka pasur informacione se djali i pronarit të Radio Plus Forte është zgjedhur deputet i Kuvendit të RMV-së. Pas marrjes së këtij informacioni, Agjencia kontaktoi me transmetuesin për konfirmim zyrtar. Radioja konfirmoi saktësinë e informacionit dhe theksoi se ishin në dijeni të situatës. Gjithashtu, informuan se prej disa muajsh janë duke zhvilluar negociata për respektimin e dispozitave ligjore, përkatësisht për tërheqjen nga struktura e pronësisë të familjarit që është bartës i funksioni publik. Ndryshimi i propozuar në strukturën e pronësisë është pjesë e procesit të harmonizimit me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive. Për pronarin e ri të propozuar është bërë kontroll në Regjistrin Qendror dhe është konstatuar se personi nuk është themelues i shoqërive të tjera tregtare, dhe as nuk figuron si pronar i vërtetë në ndonjë person tjetër juridik. Nisur nga kjo, propozohet miratimi i ndryshimit të kërkuar.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim me të cilin lejohet ndryshimi i strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive PLUS FORTE SHPKNJP Tetovë.

Ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive PLUS FORTE SHPKNJP Tetovë, nuk krijohet përqendrim i paligjshëm mediatik në kuptim të LSHMAAV, përkatësisht ky ndryshim nuk është në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi 2 ose 38 nga Ligji i njëjtë.

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive PLUS FORTE SHPKNJP Tetovë, është e detyruar të zbatojë ndryshimin e strukturës së pronësisë në Regjistrin Qendror të RMV-së, në afat prej 3 (tre) muajsh nga dita e pranimit të Vendimit, në të kundërtën, pas skadimit të afatit të caktuar, Vendimi nuk prodhon veprim juridik.

Spektori për mbështetjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

## **Pika 6**

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, ka shpjeguar Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: dhënie me qira të hapësirës për publikimin e shpalljeve në gazetatat ditore. Ajo shpjegoi se Agjencia ka detyrim ligjor që akte të caktuara t'i publikojë në gazetatat ditore që botohen në mbarë vendin, në gjuhën maqedone dhe shqipe. Prandaj, lindi nevoja për zbatimin e procedurës për furnizim publik për dhënie me qira të hapësirës për publikimin e shpalljeve. Ky furnizim është paraparë në Planin vjetor për furnizim publik të Agjencisë, dhe burimet e nevojshme financiare janë të parashikuara në Planin financiar. Në bazë të vlerës së parashikuar, procedura do të zhvillohet si furnizim me vlerë të ulët, me kriter për dhënien e kontratës do të jetë me çmim më të ulët. Procedura do të fillojë me publikimin e njoftimi në sistemin elektronik për furnizim publik, në pajtim me dispozitat e Ligjit për furnizim publik që zbatohen për furnizime me vlerë të ulët. Të gjitha informacionet shtesë gjenden në materialet e dorëzuara për këtë seancë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik: Dhënia me qira e hapësirës për publikimin e shpalljeve në gazetatat ditore.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për subjektin: Dhënie me qira të hapësirës për publikimin e shpalljeve në gazetatat ditore, është parashikuar dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2025 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive nr.05-5321/1 datë 27.12.2024, ndërsa mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

## **Pika 7**

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, ka shpjeguar Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – mallra: pajisje TIK. Ajo theksoi se ky furnizim është i paraparë në Planin Vjetor për furnizim publik të Agjencisë, ndërsa mjetet financiare janë të parashikuara në Planin Financiar. Në bazë të vlerës së parashikuar, procedura do të zbatohet si procedurë e hapur e thjeshtuar, e cila do të fillojë me publikimin e shpalljes në sistemin elektronik për furnizim publik dhe në Gazetën Zyrtare të RMV-së. Kriteri për dhënien e kontratës do të jetë çmimi më i ulët. Të gjitha informacionet shtesë gjenden në materialet e ofruara për këtë seancë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi zbatimin e procedurës për furnizim publik-mallra: pajisje TIK.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: Pajisje TIK parashihet dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2025 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive nr.05-5321/1 datë 27.12.2024, dhe fondet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive për vitin 2025.

## **Pika 8**

### **Të ndryshme**

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**